

8th ANNUAL INTERNATIONAL CONFERENCE

” Smart Mobility -
The future of green and
sustainable transport ”



Rekomandimet nga Konferenca e 8-të ndërkombëtare

“Mobiliteti i Mençur – e ardhmja e transportit të gjelbër dhe qëndrueshëm”

1. Ftohen institucioneve qeveritare që kanë mandat për sigurinë rrugore në vend që të rrisin bashkëpunimet institucionale në mes partnereve vendor dhe ndërkombëtar dhe punohet në të gjitha rrafshet që lidhen me trafikun, transportin dhe sigurinë rrugore;
2. Inkurajimi dhe domosdoshmëria e futjes në përdorim të teknologjive të reja për ta bërë lëvizje më të përshtatshme nëpër qytet për të gjithë përdoruesit e rrugës;
3. Krijimi i hapësirave të reja të destinuara për ecje, çiklizmin dhe motivimi i qytetarëve për përdorimin e transportit publik duke marrur parasysh ndikimet e energjisë dhe mjedisit.
4. Të vendosen politika dhe objektiva të qarta për favorizimin dhe masovizimin e mjeteve elektrike në trafik
5. Të bëhet shkëmbimi i rregullt i të dhënave me autoritetet e Bashkimit Evropian lidhur me të gjitha aksidentet që ndodhin në rrjetin rrugor në Kosovë dhe anasjelltas;
6. Të bëhet digjitalizimi i databazës së Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe të klasifikohen aksidentet sipas pasojave, vendit/regjioneve, formës, shkaktareve, kategorive të rrugëve, mjeteve, etj. Të digjitalizohen edhe raportet e policisë dhe të gjithë akterëve që përfshihen në aksidente;
7. Analizimi i mundësisë së aplikimit të modelit austriak lidhur me mjetet e pasiguruara si problem disa vjeçar në Kosovë. Qeveria e Austrisë aplikon një model të PPP me sektorin

e sigurimeve për të dhënë targat e makinave dhe është shumë i suksesshëm dhe ulur në 0% numrin e makinave të pa siguruara në trafik;

8. BKS të aplikoj për regjistrim në Këshillin e Byrove të Sigurimeve (kartonin e gjelbër),
9. Të realizohet arritja e marrëveshjeve bilaterale për njohjen e patentë shoferëve kosovarë dhe të gjitha vendet e BE-së;
10. Të bëhen përpjekje të vazhdueshme për njohjen e tabelave të regjistrimit nga ana e Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës;
11. Ju bëhet thirrje institucioneve qeveritare që të aprovojë legjislacionin përkatës dhe ti hapet rrugë ligjore zhvillimit të skemës të rrugëve të Kosovës dhe klasifikimit të tyre sipas yjeve të standardeve të sigurisë. Këto veprime tashmë janë të mundshme pasi që EuroRAP ka licencuar AMRKS nga Kosova si partner lokal për implementimin e Planit kombëtar të veprimit për sigurinë rrugore sipas kritereve dhe standardeve të sigurisë sipas protokolleve evropiane;
12. Të bëhen përpjekje që Kosova të anëtarësohet në të gjitha institucionet/mekanizmat ndërkombëtar që lidhen me transportin, duke mundësuar transportuesve kosovar trajtim të barabartë me transportuesit tjerë sipas të gjitha Konventave/Marrëveshjet ndërkombëtare që rregullojnë çështjen e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve;
13. Komuna e Prishtinës të vendos objektiva të qarta dhe realiste për një qytet të mençur, dhe të mos ketë vetëm projekte në letër dhe pa ndikim afatgjatë në zgjidhje të problemeve;
14. Të zbatohet infrastruktura aktuale në mënyrë të duhur dhe të monitorohen projektet dhe kërkohet rezultate konkrete nga implementuesit;
15. Komuna dhe Institucionet tjera duhet të krijojnë politika që në implementim të projekteve Smart t'i përshijnë kompanitë/institucionet të cilat e specializuara me dëshmi përkatëse të profesionalizmit në punë;
16. Komuna dhe Institucionet duhet të iniciojnë projekte konkrete në fushën e trafikut rrugor me qëllim të dixhitalizimit të pajisjeve dhe sistemeve të mençura;
17. Duhet të zhvillohen propozimet për plotësim-ndryshimin e legjislacionit në fushën e trafikut rrugor si në nivel komunal po ashtu edhe në nivel qendror si dhe të zbatohet legjislacioni aktual në përpikëri;
18. Institucionet tjera (Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe

Inovacionit, Komunitat dhe organizatat tjera), duhet të punojnë me konsistencë me masa dhe veprime konkret për uljen e mëtejme të numrit të aksidenteve dhe matjen e rezultatit të masave të ndërmarra;

19. Në të ardhmen e afërt të gjitha linjat urbane të pajisën vetëm me autobusë elektrik me qëllim të uljes së shpenzimeve, uljes së ndotjes së ajrit dhe rritjes së efikasitetit në shërbim;
20. Institucionet publike të pajisën vetëm vetura elektrike dhe ti largojnë nga përdorimi veturat me naftë, benzinë dhe gas;
21. Të ulen shpejtësia e lëvizjes nëpër qytete, në lagje dhe afër shkollave deri në 30 km/h, kjo do të ndikojë në uljen e aksidenteve dhe viktimave në njerëz;
22. Të ndiqen modelet e mira Evropiane për qytete të mëdha dhe bashkëpunohet me organizata prestigjioze në fushën e trafikut dhe mobilitetit të mëdha;
23. Të trajtohen ekspertët me trajnime profesionale të njohura ndërkombëtare, të cilat do të ju ndihmojnë në zhvillimin dhe implementimin e projekteve SMART në Kosovë.
24. Implementimi i rekomandimeve evropiane për përmirësimin e (sigurimit) të edukimit mbi sigurinë rrugore dhe lëvizshmërinë e qëndrueshme si dhe përdorni një listë të standardeve minimale të cilësisë për zhvillim, financim dhe/apo blerje të materialeve edukative.